



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/35

Datë: 27.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës dhe të nenit 3 të Rregullores Nr. 19/2017 për mënyrën e punës dhe funksionimit të Komisionit Ndërmintor për Investimet Strategjike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ndërmintor për Investime Strategjike me këtë përbërje:
 - 1.1. Rozeta Hajdari, Ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, kryesuese;
 - 1.2. Besnik Bislimi, Ministër i Financave dhe Transfereve, anëtar;
 - 1.3. Lumir Abdixhiku, Ministër i Infrastrukturës dhe Ambientit, anëtar;
 - 1.4. Besian Mustafa, Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 1.5. Emilija Redzeqi, Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtare;
 - 1.6. Kryetari i Komunës në të cilën realizohet investimi strategjik, anëtar;
 - 1.7. Ministri përgjegjës për sektorin në të cilën realizohet investimi strategjik, anëtar; dhe
 - 1.8. Sami Istrefi, Avokat i Përgjithshëm Shtetëror, anëtar.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/35
Datë: 27.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) si dhe të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

Qeveria e Republikës së Kosovës aprovon kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë si në vijim:


- I. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/13 i datës 18/03/2020 me të cilin Qendra e studentëve në Prishtinë është caktuar si hapësirë karantine;
- II. Shfuqizohet Vendimi i GNMI MPBAP Nr. 140/2020 dt. 25/03/2020 me të cilin është caktuar qendra për të huaj në Vranidoll si hapësirë karantine;
- III. Ministria e Shëndetësisë obligohet të sigurojë që personat që gjenden në zonat e karantinës (Qendra e studentëve dhe Vranidoll) t'i nënshtrohen testit për Covid 19 (RT PCR) dhe të njëjtit të lirohen në vetëizolim për 14 ditët e ardhshme, nën mbikëqyrjen e ekipeve mjekësore dhe njësive tjera përkatëse;
- IV. Të gjithë personat që hyjnë në Republikën e Kosovës obligohen të vetizolohen për 14 ditë të ardhshme, nën mbikëqyrjen e ekipeve mjekësore dhe njësive tjera përkatëse;
- V. Të gjitha Vendimet tjera që kanë rregulluar procedurat e karantinës shfuqizohen;
- VI. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.

VII. Vendimi hyn në fuqi me dt. 30 maj 2020.

A r s y e t i m

Meqenëse situata epidemiologjike në vend konsiderohet me rrezik të reduktuar, krahasuar me situatën paraprake, e konstatuar nga IKShPK-ja dhe zyra e OBSH-së në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë